

Microsoft Albania sh.p.k.
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	
Pasqyra e pozicionit finanicar	3
Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet e pasqyrave financiare	7 – 24

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar drejtimit dhe aksionarëve të Microsoft Albanian Sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Microsoft Albanian sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethanat e caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Microsoft Albania sh.p.k. më 31 dhjetor 2015, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
29 qershor 2016
Tiranë, Shqipëri

Nuriona Sokoli Berdica
Partner Angazhimi

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Ad: Rr. Elbasanit, Pli. nr. 1, kt. 2, poshte Fakultetit Gjeologji Miniera
Tel: 044517920
NIPT: L 41709002 H TIRANA - ALBANIA

Microsoft Albania sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek)

Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Aktive		
Aktive afatgjata materiale	6	535
Totali i aktiveve afatgjata	63	535
Aktive tatimore të shtyra	7	1,121
Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	8	987
Tatim fitimi i arkëtueshëm		-
Të ardhura të llogaritura	9	7,904
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	41,496
Të tjera të arkëtueshme	11	326
Paraja dhe ekuivalentet e saj	12	44,404
Totali i aktiveve afatshkurtra	105,207	96,238
Totali i aktiveve	105,270	96,773
Kapitali dhe detyrimet		
Kapitali aksionar	13	100
Fitimi i pashpërndarë		46,956
Fitimi i vitit		10,226
Totali i kapitalit	75,697	57,282
Hua nga institucione financiare	14	417
Totali i detyrimeve afatgjata	-	417
Të ardhura të periudhave të ardhme	15	12,213
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	16	16,783
Provizjone për detyrime tatimore	17	7,306
Tatimi mbi fitimin e pagueshëm		2,772
Totali i detyrimeve afatshkurtra	29,573	39,074
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	105,270	96,773

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm më 31 mars 2016 dhe janë firmosur nga:

Sokol Vladi
Drejtor i Përgjithshëm

Përgatitur nga:
Ernst & Young Albania sh.p.k



Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.**Pasqyra e fitim / humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shitje neto	18	115,906	109,590
Të ardhura të tjera		769	51
Shpenzime zhvlerësimi	6	(1,089)	(1,956)
Shpenzime personeli	19	(15,750)	(16,177)
Shpenzime operative të tjera	20	(80,555)	(81,151)
Fitimi operativ		19,280	10,357
Kosto financiare, neto		(23)	(97)
Fitim nga kursi i këmbimit, neto	21	3,822	3,951
Fitimi para tatimit		23,079	14,211
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(4,665)	(3,984)
Fitimi neto për vitin		18,415	10,226
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse		18,415	10,226

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek)

	Kapitali aksionar	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2014	100	46,956	47,056
Fitimi neto i vitit 2014	-	10,226	10,226
Gjendja më 31 dhjetor 2014	100	57,182	57,282
Fitimi neto i vitit 2015	-	18,415	18,415
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	100	75,597	75,697

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Microsoft Albania sh.p.k.

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë shprehur në'000 Lek)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
AKTIVITETE OPERATIVE		
Fitimi para tatimit	23,079	14,211
Rregullime për:		
Zhvlerësimi	6 1,089	1,956
Ndryshim ne provigjione per detyrime tatimore	(5,362)	(7,306)
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative	18,806	8,861
<i>Ndryshimi në kapitalin punues</i>		
(Rritje)/ rënie në parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	(63)	(27)
(Rritje)/ rënie në të ardhurat e llogaritura	(25,421)	(3,274)
Rritje/ (rënie) në të tjera të arkëtueshme	6,717	(875)
(Rënie)/ rritje në llogari të arkëtueshme	(6,063)	22,774
Rënie në të ardhurat e periudhave të ardhme	(663)	(3,466)
(Rënie)/ rënie në llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	(703)	(6,345)
Tatimi fitimi paguar	(7,876)	(3,263)
Rrjedha e parasë neto përdorur në/nga veprimtaritë operative	(15,266)	14,385
AKTIVITETE INVESTUESE		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(617)	(813)
Rrjedha e parasë neto e përdorur në aktivitetet investuese	(617)	(813)
AKTIVITETE FINANCUESE		
Ripagime të qirasë financiare	(417)	(1,035)
Pagime të interesave të qirasë financiare	-	-
Rrjedha e parasë neto e përdorur në aktivitetet financuese	(417)	(1,035)
(Rënie)/ Rritje neto e parasë	(16,300)	12,537
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	12 44,404	31,867
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	12 28,104	44,404

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Microsoft Albania ("Shoqëria") u themelua më 30 qershor 2008 si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe u regjistrua sipas vendimit të gjykatës në të njëjtën datë, me NIPT K8183001C dhe numër serial certifikate: SN-055925-05-09.

Aksionari i Shoqërisë është Microsoft Corporation, e cila zotëron 100% të aksioneve. Microsoft është një korporatë software-sh me bazë në SHBA, e regjistruar më 22 shtator 1993, me seli në Redmond, Washington.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve të zhvillimit të tregut, lokalizimit dhe shërbime të lidhura me programe kompjuterike dhe hardware, duke përfshirë pa asnjë kufizim shërbimin teknik, trajnimin dhe këshillimin.

Më 31 dhjetor 2015, Shoqëria kishte 2 punonjës (2014: 2). Zyrat e Shoqërisë ndodhen në Rrugën Abdyl Frashëri, P.11/1, EGT Tower Kati 2, Tiranë, Shqipëri.

Drejtuesit dhe Manaxherët më 31 dhjetor 2015 dhe 2014

Benjamin Owen Orndorff
Keith Ranger Dolliver
Agim Bekaj
Sokol Vladi

Administrator
Administrator
Drejtor i Përgjithshëm deri me 30.10.2015
Drejtor i Përgjithshëm nga 01.11.2015

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Në përputhje me Ligjin Nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazën e kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese


Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur dhe paraqitur në Lek, që është monedha e mjedisit ekonomik parësor në të cilin Shoqëria kryen aktivitetin e saj.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

Në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë, Drejtimi ka bërë gjykimin në vijim, përveç atyre që përfshijnë vlerësime (shih më poshtë), i cili ka efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare:



2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve (vazhdim)

Njohja e aktivitetit të shtyrë

Njohja e aktivitetit të shtyrë bazohet në faktin nëse ka apo jo më shumë mundësi të ketë fitime të mjaftueshme dhe të përshtatshme në dispozicion në të ardhmen, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme. Njohja pra, përfshin gjykim në lidhje me rezultatet e ardhshme të Shoqërisë.

Vlerësime dhe supozime

Supozimet kryesore për të ardhmen dhe burimet e tjera të rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë në fund të periudhës raportuese, të cilat kanë rrezik të konsiderueshëm për shkaktimin e një rregullimi material në shumat e mbetura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë.

Jetëgjatësia e aktiveve afatgjata materiale

Kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale përfshin përdorimin e vlerësimeve për përcaktimin e jetëgjatësisë të këtyre aktiveve si dhe vlerat e rikuperueshme të tyre. Përcaktimi i jetëgjatësive të këtyre aktiveve bazohet në gjykimin e Drejtimit. Jetëgjatësitë paraqiten në shënimin 4.3. Shoqëria i rishikon këto vlerësime në fund të çdo periudhe raportimi.

3. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.1 Standardet e reja dhe interpretimet

Standardet e reja dhe të rishikuara të mëposhtme u bënë efektive për Shoqërinë duke filluar nga data 1 Janar 2015:

Standardet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale.

- **Ndryshimet në SNK 19 skema përfitimesh të përcaktuara: Kontributet e punonjësve.** SNK 19 kërkon që njësia ekonomike të marrë në konsideratë kontributet nga punonjësit ose palët e treta, kur kontabilizon për skemat me përfitime të përcaktuara. Ku kontributet janë të lidhura me shërbimin, ato duhet t'i atribuohet periudhës së shërbimit si një përfitim negativ. Këto ndryshime sqarojnë se, në qoftë se shuma e kontributeve është e pavarur nga numri i viteve të shërbimit, një njësia ekonomike lejohet të njohë kontributet e tilla si një reduktim të kostos së shërbimit në periudhën në të cilën shërbimi është dhënë, në vend të ndarjes së kontributet për periudhat e shërbimit. Ky amendament është efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Korrik 2014. Ky ndryshim nuk është relevant për Degën, pasi ajo nuk ka plane për përfitime të përcaktuara me kontribute nga punonjësit ose palët e treta.
- **SNK 16 Toka, Ndertesa, Makineri e Paisje dhe SNK 38 Aktivitet Jo-materiale**
Ndryshimi aplikohet në mënyrë retrospektive dhe sqaron në SNK 16 dhe SNK 38 që aktivi mund të jetë rivlerësuar duke iu referuar të dhënave të vëzhguara nga ose duke rregulluar shumën bruto kontabël të aktivitetit me vlerën e tregut ose me përcaktimin e vlerës së tregut të vlerës kontabël dhe rregullimin e vlerës kontabël bruto në mënyrë proporcionale në mënyrë që vlera kontabël të jete e barabartë me vlerën e tregut. Përveç kësaj, amortizimi i akumuluar apo amortizimi është diferenca mes shumës bruto dhe vlerës së mbartur të aktivitetit. Ky ndryshim nuk ka pasur ndonjë ndikim të Shoqëria gjatë periudhës aktuale.

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

3.1 Standardet e reja dhe interpretimet (Vazhdim)

- **SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura.** Ndryshimi aplikohet në mënyrë retrospektive dhe sqaron se një njësi e menaxhimit (një njësi ekonomike që ofron shërbime të rëndësishme të menaxhimit të personelit) është një pale e lidhur dhe subjekt në dhënien e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura. Përveç kësaj, një njësi ekonomike që përdor një njësi të menaxhimit është e nevojshme për të dhene informacion mbi shpenzimet e bëra për shërbimet e menaxhimit. Përveç kompanise meme, Shoqëria nuk ka mardhenie të tjera të ngjashme dhe nuk ka marrë ndonjë shërbime të menaxhimit nga subjekte te tjera.
- **SNRF 13 Matja me vleren e drejte**
- **SNK 40 Investimet ne pasuri**

Aplikimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka sjellë asnjë ndryshim të rëndësishëm në politikat kontabël të Shoqërisë.

3.2 Standardet dhe interpretimet e publikuar por ende jo në fuqi

Një numër standardesh, rishikimesh të standardeve dhe interpretime të standardeve janë efektive për vitet që fillojnë pas datës 1 janar 2015 (të listuara më poshtë), dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- **SNRF 9 Instrumentat Financiare** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2018 ; adoptimi i hershëm është i lejuar).

Në korrik të vitit 2014, BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentat Financiarë që zëvendëson SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 sjell së bashku të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimi dhe matjes, dëmtim dhe kontabiliteti mbrojtës. SNRF 9 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me aplikimin e hershme e lejuar. Dega në plan të miratojë standard të ri në datën e kërkuar efektiv dhe në përgjithësi ajo nuk pret ndikim të rëndësishëm në bilancin e saj dhe barazi. Ky ndryshim, nuk ka ndonjë efekt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 14 Rregullatore llogaritë e shtyra** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016).

SNRF 14 është një standard opsional që lejon një njësi ekonomike, aktivitetet e të cilit i nënshtrohen rregullimit te normës, për të vazhduar aplikimin e shumices së politikave të saj ekzistuese të kontabilitetit për rregullatore te llogarive te shtyra pas perdorimit për herë të parë te SNRF. Shoqëria i pregatit pasqyrat e saj bazuar ne SNRF, prandaj ky standard nuk do të zbatohet.

- **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2018). SNRF 15 u lëshua në Maj 2014 dhe krijon një model prej pesë-hapash për të llogaritur të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në një vlerë që pasqyron konsideratën për të cilën njësi ekonomike pret të marre në këmbim te transferimit te mallrave ose shërbimeve për një klient. Standardi i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale per njohjen e të ardhurave nën SNRF. Aplikimi i standartit te ri behet i plotë retrospektivisht ose retrospektivisht i modifikuar dhe është i nevojshem për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, kur IASB te finalizoj amendamentet për të shtyrë datën efektive të SNRF 15 për një vit. Perdorimi i hershëm është i lejuar..

- **SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta (ndryshimet): Kontabiliteti për Blerjet e Interesave në Operacione të Përbashkëta** (i vlefshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).



(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA (VAZHDIM)

3.2 Standardet dhe interpretimet e publikuar por ende jo në fuqi (Vazhdim)

- **SNK 16 Toka, ndertesa, makineri dhe pajisje dhe SNK 41 Bujqesia (Ndryshimet): Bime prodhuese** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2016)

SNRF 16 zëvendëson standardin e mëparshëm për qiratë, SNK 17 Qiratë. Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen e qirave për të dyja palët në një kontratë, pra klientit ("qiramarrësi") dhe furnizuesit ("qiradhënësi"). SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave ose si qira operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, paraqet një model të vetëm kontabël të qiramarrësit. Duke aplikuar këtë model, një qiramarrës është i detyruar të njohë: (a) aktivet dhe pasivet për të gjitha qiratë me afat prej më shumë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi bazë është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimi i asetëve me qira veçmas nga interesi në detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16 në thelb mbart kërkesat e kontabël të qiradhënësit në SNK 17. Në përputhje me rrethanat, një qiradhënësi vazhdon të klasifikojë qiranë e tij si qira operative ose qira financiare, dhe të paraqesë ndryshe këto dy lloje të qirave.

- **SNK 27 Pasqyrat Financiare (i ndryshuar)** (ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2016)
- **Ndryshimi ne SNRF 10 Pasqyrat financiare te konsoliduara dhe SNK 28 Investimet ne pjesemarrje dhe sipermarrjet e perbashketa: Shitje ose kontributi i Pasurive mes nje Investitor dhe bashkepunetor te tij ose sipermarrje te perbashket** (ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2016)

Shoqëria ka zgjedhur të mos i aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave efektive të tyre.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek ("monedha funksionale") me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë në monedhë të huaj janë konvertuar në Lek me normat e datës së raportimit. Zërat jo-monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë që janë në monedhë të huaj janë konvertuar me normën në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë të cilët janë matur në koston historike në monedhë të huaj nuk janë konvertuar.

Diferencat e konvertimit që lindin nga shlyerja e zërave monetarë dhe nga rikonvertimi i zërave monetarë, janë të përfshira në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave për periudhën.

Kursi efektiv në fund të vitit ndërmjet Lek-ut dhe monedhave të tjera është si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
USD	125.79	115.23
EUR	137.28	140.14

4.2 Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht njih llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat e parave në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë aktivet e caktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e dispozitive kontraktuese të instrumentit. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të parasë u mbaron afati, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhat kontraktuale të parasë të aktiveve financiare në një transaksion në të cilin të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së aktiveve financiare janë transferuar. Çdo interes mbi aktivet financiare të transferuara që është krijuar, ose mbahet nga Shoqëria është i njohur si një aktiv ose detyrim i veçantë.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shumat neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim ose për të zgjidhur në baza neto ose për të njohur aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentat financiare jo-derivativë të Shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, paraaja dhe ekuivalentet e saj, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera dhe huatë.

Paraaja dhe ekuivalentet e saj

Paraaja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë parane në arkë dhe llogaritë rrjedhëse.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht sipas vlerës së drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv pa humbjen nga rënia në vlerë.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera janë paraqitur në vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke njohur shpenzime interesi sipas bazës së interesit efektiv.

Metoda e normës së interesit efektiv

Metoda e normës së interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për shpërndarjen e shpenzimit të interesit mbi periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma e cila skonton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, aty ku është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

Kontabilizimi për të ardhurat dhe shpenzimet financiare është diskutuar në politikën kontabël 4.7.

4.3 Aktivitet afatgjata materiale

(i) *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo rënie në vlerë të akumuluar. Kosto përfshin shpenzimin që është përfshirë direkt në blerjen e aktivitet. Kosto e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe koston direkte të punës, çdo kosto tjetër të përfshirë direkt në sjelljen e aktivitet në kushte pune për qëllimin e përcaktuar, koston e çmontimit dhe largimit të pjesëve dhe restaurimit të vendit në të cilin ato janë vendosur si dhe koston e kapitalizuara të huamarrjes.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme kontabilizohen si elemente të veçanta (komponent kryesor) të aktiveve afatgjata materiale. Të ardhurat dhe humbjet nga shitja e një aktivitet afatgjatë material përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja e aktivitet afatgjatë material me vlerën kontabël të tij dhe njihen me vlerë neto në të ardhura të tjera në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

(ii) *Kostot vijuese*

Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.



4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KYRESORE KONTABËL (VAZHDIM)**4.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***(iii) Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi llogaritet mbi vlerën e zhvlerësueshme, e cila është kosto e një aktivi, ose një vlerë zëvendësuese e kostos, minus vlerën e tij të rikuperueshme. Zhvlerësimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sipas bazës lineare përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të secilit grup të aktiveve afatgjata materiale, duke qenë se kjo e reflekton më mirë modelin e pritshëm të konsumimit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të trupëzuara në një aktiv. Toka nuk zhvlerësohet. Jetëgjatësitë e vlerësuara për periudhën aktuale si dhe për periudhën krahasuese janë si më poshtë:

<i>Kategoritë</i>	<i>Vitet</i>
Pajisje zyre	3
Automjete	3
Mobilje dhe orendi	3
Pajisje dhe programe kompjuterike	1-2

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësitë dhe vlerat e rikuperueshme rishikohen në fund të çdo viti financiar si dhe bëhen rregullime nëse është e përshtatshme.

4.4 Rënia në vlerë*Aktivet financiare*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë përmes fitimit/humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar ka rënie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e ardhshme të parasë nga aktivi, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerën e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare të interesit efektiv. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave (në humbje ose fitim) dhe reflektohen në një llogari provigjoni të kundërt me llogaritë e arkëtueshme. Interesi nga aktivitetet e zhvlerësuara vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumata përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

Aktivet jo-financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit në mënyrë që të përcaktohet nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse një e dhënë e tillë ekziston, në këtë rast vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontojnë me vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë nuk janë rregulluar.

Aktivet jo-financiare (vazhdim)

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisive të saj gjeneruese të parasë e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave (në humbje ose fitim).

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL KRYESORE (VAZHDIM)

4.5 Njohja e të ardhurave

E ardhura është hyrja bruto e përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, e cila gjenerohet përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë. E ardhura matet me vlerën e drejtë të të drejtave të arketuara ose që priten të arkëtohen. E ardhura zvogëlohet me vlerën e kthimeve të vlerësuara të klientëve, rabateve dhe zbritjeve të ngjashme, nëse ka.

E ardhura në lidhje me komisionet nga Microsoft Corporation që ka të bëjë me aktivitetet e zhvillimit të tregut, kërkimit dhe zhvillimit njihet kur ndodhin shpenzimet e lidhura me to.

E ardhura nga shërbimet ndaj palëve të treta bazuar në kontratat e shërbimeve njihet në bazë të fazës së përfundimit të kontratës së shërbimit dhe / ose të kohës së punuar dhe burimeve të kontraktuara materiale dhe njerëzore.

Kur shërbimet janë kryer nga një numër i pacaktuar veprimesh përgjatë një peridhe të caktuar kohe, e ardhura njihet mbi bazë lineare përgjatë periudhës së specifikuar, për aq kohë sa nuk ka dëshmi se një metodë tjetër e përfaqëson më mirë fazën e përfundimit.

4.6 Qiratë

Qiratë klasifikohen në qira financiare në çdo rast që kushtet e marrëveshjes i transferojnë qiramarrësit të gjitha të drejtat dhe rreziqet nga pronësia. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operative.

Aktivitetet e mbajtura sipas një marrëveshjeje qiraje financiare njihen si aktive të Shoqërisë me vlerën e tyre të drejtë në datën e krijimit të marrëveshjes ose, nëse është më e vogël, me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë. Detyrimi përkatës kundrejt qiramarrësit përfshihet në pasqyrën e pozicionit financiar si një detyrim për qira financiare.

Pagesat e qirasë ndahen midis pagesave të interesit dhe pakësimeve të detyrimit për qira në mënyrë që të arrihet një normë konstante interesi për vlerën e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare njihen direkt në humbje ose fitim.

Pagesat e bëra për qira operative njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sipas bazës lineare përgjatë periudhës së qirasë.

4.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë nëpër banka si dhe të ardhurat nga kurset e këmbimit, të cilat njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në aktivet financiare njihet në të ardhurat nga interesi.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa mbi huatë dhe detyrimet mbi qiranë, si dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në detyrimet financiare njihet në shpenzimet e interesit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.

4.8 Të ardhura dhe shpenzime të tjera

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara në momentin që shërbimet janë siguruar.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.9 Tatimi

Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe përfaqëson shumën e tatimit të pagueshëm të periudhës dhe tatimin e shtyrë.

Tatimi i periudhës është tatimi i pagueshëm i pritshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit të zbatueshme në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim mbi tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sepse ai përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera si dhe përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

Tatimi i shtyrë regjistrohet duke përdorur metodën e bilancit dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar sipas diferencave të përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime fiskale.

Vlera e tatimit të shtyrë bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit ose shlyerjes së vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat e tatimit të miratuara dhe në fuqi në datën e raportimit.

Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjithë diferencën e përkohshme të tatueshme dhe aktivet për tatimin e shtyrë njihen vetëm në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme do të jenë të disponueshme, kundrejt të cilave mund të aplikohen diferencat e përkohshme të zbritshme. Aktivet për tatimin e shtyrë zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi i lidhur me to të mund të realizohet.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që pritet të aplikohet në periudhën kur detyrimi shlyhet ose kur aktivi realizohet dhe ngarkohet ose kreditohet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, me përjashtim kur ai lidhet me zëra të cilët ngarkohen ose kreditohen direkt në kapital, në këtë rast tatimi i shtyrë shpërndahet gjithashtu në kapital.

5. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË

Disa nga politikat dhe paraqitjet e Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, edhe për aktivet dhe detyrimet financiare edhe për ato jo financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si më poshtë:

(a) Niveli 1: Cmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara), në tregjet aktive për aktive ose pasive identikisht të njëjta.

(b) Niveli 2: Teknikat e vlerësimit, për të cilat niveli më i ulët i të hyrave që është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë është në mënyrë direkte ose indirekte i vëzhgueshëm.

(c) Niveli 3 : Teknikat e vlerësimit, për të cilat niveli më i ulët i të hyrave që është i rëndësishëm në matjen e vlerës së drejtë është në mënyrë direkte ose indirekte i pavëzhgueshëm.

Shoqëria ka vetëm nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare jo-derivative (e cila përcaktohet vetëm për qëllime të paraqitjes) dhe vlera e drejtë nuk devijon nga vlerat e tyre kontabël.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur në 31 Dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Kosto historike

	Makina nën qira financiare	Pajisje zyre	Mobilije dhe orendi zyre	Të tjera	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2014	3,084	4,614	1,761	3,779	13,238
Shtesa gjatë 2015	-	617	-	-	617
Nxjerrje jashtë përdorimi gjatë 2015	(3,084)	-	-	-	(3,084)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	5,231	1,761	3,779	10,771

Amortizimi i akumuluar

Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,682	4,610	1,761	3,650	12,703
Amortizimi për vitin 2015	402	621	-	66	1,089
Nxjerrje jashtë përdorimi gjatë 2015	(3,084)	-	-	-	(3,084)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	5,231	1,761	3,716	10,708

Gjendja më 31 dhjetor 2015

Vlera kontabël

Më 31 dhjetor 2014	402	4	-	129	535
Më 31 dhjetor 2015	-	-	-	63	63

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. AKTIVET TATIMORE TË SHTYRA

Aktivet tatimore të shtyra janë analizuar si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Tatime të shtyra që lindin nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata mbi normat e lejuara	515	703
Tatime të shtyra që lindin nga bonuset e përlogaritura	154	418
Totali	669	1,121

Lëvizje në aktivet tatimore të shtyra:

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Gjendja në fillim të vitit	1,122	926
Kredituar tek pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave (shënimi 20)	(453)	195
Gjendja në fund të vitit	669	1,121

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË PERIUDDHAVE TE ARDHME

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Garanci për qira zyre	788	788
Parapagime furnitorëve	262	199
	1,050	987

Garancia për qiranë e zyrave është dhënë në përputhje me kontratën e firmosur. Parapagimet e kryera nga furnitorët përfshijnë shërbime që do të përfitohen në periudha të ardhshme si: shërbime interneti, sigurim makine, etj.

9. TE ARDHURA TE LLOGARITURA


	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Të ardhura të llogaritura	33,325	7,904
Total	33,325	7,904

Te ardhurat e llogaritura perbehen nga te ardhurat per sherbimet profesionale teknike te Microsoft (MCS) te kryera, bazuar mbi kontratat dhe marreveshjet me klientet, te njohura sipas metodes se fazes se perfunduar dhe per te cilat faturimi si dhe arketimi i pageses ndodh ne periudhen pasuese raportuese.

10. LLOGARITE E ARKETUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme tregtare përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Llogari të arkëtueshme nga Mëma	27,471	41,254
Llogari të arkëtueshme nga klientë në lidhje me sherbime Premier	4,238	242
Llogari të arkëtueshme nga nënkontraktorë në lidhje me sherbime MCS	2,746	-
Llogari të arkëtueshme nga klientë të tjerë	324	-
Totali	34,779	41,496



Microsoft Albania sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2015***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***11. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA**

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
TVSH e arketueshme	6,008	-
Te arketueshme nga autoriteti tatimore	223	326
Paradhenie punonjësve	158	-
Totali	6,389	326

12. PARAJA DHE EKUIVALENTET E SAJ

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Para në arkë	4	13
Para në bankë	28,100	44,391
<i>Llogari rrjedhëse në LEK</i>	<i>26,592</i>	<i>43,796</i>
<i>Llogari rrjedhëse në USD</i>	<i>1,508</i>	<i>608</i>
Totali	28,104	44,404

13. KAPITALI AKSIONAR

	Më 31 dhjetor 2015		Më 31 dhjetor 2014	
	Numri i aksioneve	Lek	Numri i aksioneve	Lek
Microsoft Corporation	100	100	100	100
	100	100	100	100

Shoqëria është regjistruar në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në 30 qershor 2008 me NIPT K81830011C, me kapital të paguar prej 100,000 Lek i ndarë në 100 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek secila. Microsoft Corporation zotëron 100% të aksioneve.

14. HUA NGA INSTITUCIONET FINANCIARE

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
<i>Pjesa afatgjatë, 1 deri në 5 vjet</i>		
Detyrimet nga qiraja financiare (ii)	-	417
Totali	-	417

i. Qiraja financiare

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2011, Shoqëria ka blerë dy automjete të reja nga Tirana Leasing sh.a. që mbart një normë nominale interesi të barabartë me EURIBOR 12 mujor + 5%.

Gjatë vitit 2014, për një nga automjetet, Microsoft Albania sh.p.k nënshkroi me Tirana Leasing sh.a një marrëveshje për kalimin e kontratës nga Microsoft Albania sh.p.k tek një prej punonjësve të saj. Nëpërmjet kësaj marrëveshje të gjitha detyrimet përkundrejt Tirana Leasing sh.a në lidhje me marrëveshjen e qerasë financiare për këtë automjet, janë transferuar nga qeramarrësi (Microsoft Albania sh.p.k) te qeramarrësi zëvendësues.

Gjatë vitit 2015 asnjë automjet nuk është blerë me qera financiare.

15. TE ARDHURA TE PERIUDHAVE TE ARDHME

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Te ardhura te periudhave te ardhme	11,550	12,213
Total	11,550	12,213

Të ardhurat e periudhave të ardhme përfaqësojnë të ardhura të periudhës në vijim për shërbime të faturuara ne avancë bazuar ne kontratat me klientët.

16. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Shpenzime të llogaritura (i)	14,093	15,211
Detyrime ndaj furnitorëve	1,704	160
Detyrime të tjera tatimore (ii)	282	1,412
Totali	16,079	16,783

Shpenzimet e llogaritura përfaqësojnë kryesisht kosto shërbimesh të llogaritura të marra nga nënkontraktorët për kryerjen e shërbimeve profesionale teknike të Microsoft (MCS), shërbime për qëllime marketing, shpenzime të llogaritura për bonuse për personelin.

(i) Shpenzime të llogaritura

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Shpenzime të llogaritura për shërbimet profesionale teknike të Microsoft (MCS)	12,017	1,490
Shpenzime të llogaritura për bonuse	1,029	2,789
Shpenzime të tjera të llogaritura	846	300
Shpenzime të llogaritura për marketing	129	250
Shpenzime të llogaritura për personelin	72	155
Shpenzime të llogaritura për shërbime mbështetje teknike	-	10,227
Total	14,093	15,211

(i) Detyrime të tjera tatimore

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Tatimi mbi të ardhurat personale	156	176
Sigurime shoqërore	76	78
Tatim ne burim	50	-
Tatim mbi vlerën e shtuar	-	1,158
Totali	282	1,412

17. PROVIGJIONE PER DETYRIME TATIMORE

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Provigjione për detyrime tatimore	1,944	7,306
Total	1,944	7,306

Provigjonet për detyrime tatimore më 31 dhjetor 2015, konsistojnë në penalitete për detyrime të ardhshme të tatim fitimit me vlere 1,944 mijë Lek, te cilat mund të vijnë si rezultat e rivlerësimeve nga ana e autoriteteve tatimore, në lidhje me korigjimin e të ardhurave dhe kostove për shërbimet MCS për vitet 2011-2013, nëpërmjet amendimit të balancave komparative për vitin 2013 në pasqyrat financiare te vitit 2014, si dhe kërkesës së dorëzuar pranë autoriteteve tatimore në lidhje me amendimin e deklarave të tatim fitimit të periudhave përkatëse, të lartpërmendura.

18. SHITJE NETO

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga shërbimet	111,882	91,211
Të ardhura nga komisionet	4,024	18,379
Totali	115,906	109,590

E ardhura nga shërbimet lidhet me shërbimet e ofruara ndaj palëve të treta për mbështetje teknike dhe shërbime profesionale teknike.

Të ardhura nga komisionet përfaqësojnë komisionet e faturura ndaj Microsoft Corporation në lidhje me aktivitetet për zhvillimin e tregut të kryera nga Shoqëria. Komisionet llogariten bazuar në shpenzimet mujore operacionale të kryera për zhvillimin e aktiviteteve me një shtesë marzhi prej 13% mbi kostot totale, duke zbritur të ardhurat e realizuara nga shërbimet ndaj palëve të treta.

19. SHPENZIME PERSONELI

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Paga dhe përfitime të tjera	15,215	15,510
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	535	667
Totali	15,750	16,177

Paga dhe përfitime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 përfshin bonuset në shumën 1,364 mijë LEK (2014: 1,248 mijë LEK).

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

20. SHPENZIME OPERATIVE TË TJERA

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shërbime të nënkontraktuara	31,667	31,590
Shërbime ligjore dhe financiare	21,711	15,005
Shpenzime reklame	9,560	9,349
Qira	6,008	5,750
Diete-Shpenzime udhëtimi dhe akomodimi	4,570	5,005
Mirëmbajtje	1,824	323
Pritje dhe përfaqësime	1,088	520
Provizjone dhe shpenzime të tjera jo të zbritshme	1,001	4,283
Internet	882	899
Gjoha	844	6,986
Telefon	618	596
Shërbime bankare	380	337
Shpenzime zyre	149	120
Shpenzime sigurimi	133	256
Shërbime postare	86	64
Shpenzime të tjera	34	68
Totali	80,555	81,151

Shërbime të nënkontraktuara përfshijnë kryesisht shërbime të lidhura me shërbime profesionale teknike (MCS) të marra nga IKUB Info.

Provizjone dhe shpenzime të tjera jo të zbritshme përfshijnë shpenzime të llogaritura (provizjone) për bonuse si dhe shpenzime të tjera nga të tretë.

21. FITIM NGA KURSI I KËMBIMIT NETO

	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2014
Humbje nga kursi i këmbimit	(450)	(345)
Fitimi nga kursi i këmbimit	4,272	4,296
Totali	3,822	3,951

22. TATIMI MBI FITIMIN

Norma standarde e tatimit për vitin, bazuar në normën standarde shqiptare të tatimit mbi fitimin është 15% (2014: 15%); shpenzimi për vitin mund të rakordohet me fitimin kontabël si në vijim:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	23,079	14,211
Tatimi mbi fitimin	3,462	2,132
<i>Efekti tatimor i:</i>		
Shpenzimeve të pazbritshme	751	2,049
Shpenzimi /(të ardhurat) për tatimin e shtyrë	452	(196)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin i njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave	4,665	3,984

22. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Shpenzimi/(e ardhura) për aktivin/pasivin tatimor të shtyrë është njohur si rezultat i diferencave të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve/pasiveve dhe bazës së tyre tatimore, në lidhje me bonuset e llogaritura për punonjësit, aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe provigjione për detyrime tatimore.

Shpenzime të pazbritshme përfaqësojnë kryesisht shpenzimet të pa mbeshtetura me faturat të rregullta tatimore si dhe penalitete tatimore.

Tatim fitimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzimet e vitit actual 15% (2014: 15%)	4,213	4,180
Shpenzime tatimi i shtyrë / (të ardhura)	452	(196)
Shpenzime tatim fitimi	4,665	3,984

23. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari të arkëtueshme:		
Microsoft Ireland Operations Ltd.	27,471	41,254
Totali	27,471	41,254

Gjatë vitit Shoqëria ka kryer transaksionet e mëposhtme me Microsoft Corporation dhe Microsoft Ireland Operations Lmted.:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Komisione	4,024	18,379
Totali	4,024	18,379

Shperblime te menaxhimit detajohen si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpërblime për manaxhimin	11,746	9,396
Totali	11,746	9,396

24. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Një instrument financiar është çdo kontratë që bën të mundur krijimin e një të drejte për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar), ose krijimin e një detyrimi për t'i transferuar mjete monetare ose aktive të tjera financiare një pale tjetër (detyrim financiar). Instrumentat financiarë e ekspozojnë Shoqërinë ndaj disa rreziqeve. Më të rëndësishmet janë paraqitur më poshtë.

a) Rreziku i kredisë

Instrumentat financiarë, të cilat e bëjnë Shoqërinë subjekt të rrezikut të kredisë, konsistojnë kryesisht në llogari të arkëtueshme të tjera dhe mbajtje të parave. Rreziku i kredisë i Shoqërisë manaxhohet duke vendosur mjetet e saj monetare në institucione financiare me cilësi të lartë.

24. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Maksimumi i rrezikut të kredisë ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar është si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari të arkëtueshme tregtare	34,779	41,496
Para në bankë	28,104	44,404
Totali	62,883	85,900

b) Rreziku i likuiditetit

Shoqëria siguron vazhdimësi të financimeve. Huatë e saj janë të ndara në hua dhe qira financiare. Fleksibiliteti afatshkurtër arrihet duke mbajtur mjete të mjaftueshme monetare dhe duke përdorur lehtësirat e overdraftit, sipas nevojës.

Më poshtë janë paraqitur maturitetet e kontraktuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare, duke përfshirë edhe pagesat e interesit deri më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

31 dhjetor 2015	Vlera kontabël	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Më shumë se 1 vit
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme tregtare	34,779	34,779	-	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	28,104	28,104	-	-
Totali	62,883	62,883	-	-
<i>Detyrime financiare</i>				
Hua nga institucionet financiare	-	-	-	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	27,629	27,629	-	-
Totali	27,629	27,629	-	-
Pozicioni neto	35,254	35,254	-	-
31 dhjetor 2014	Vlera kontabël	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Më shumë se 1 vit
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme tregtare	41,496	41,496	-	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	44,404	44,404	-	-
Totali	85,900	85,900	-	-
<i>Detyrime financiare</i>				
Hua nga institucionet financiare	417	-	-	417
Llogari të pagueshme dhe të tjera	28,997	28,997	-	-
Totali	29,413	28,997	-	417
Pozicioni neto	56,487	56,904	-	(417)

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

24. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**c) Rreziku i kursit të këmbimit**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit sidomos në lidhje me financimet përmes qirave financiare si dhe në lidhje me komisionet nga Microsoft Corporation në lidhje me marketingun dhe aktivitetet e zhvillimit. Këto marrëveshje më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë kryer në USD. Shoqëria nuk ka përdorur instrumenta derivative për të kufizuar ekspozimin e saj ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit dhe normat e interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë sipas monedhave më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

31 dhjetor 2015	Vlera kontabël	USD	EUR	Lek
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme tregtare	34,779	34,779	-	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	28,104	1,508	-	26,596
	62,883	36,287	-	26,596
<i>Detyrime financiare</i>				
Huatë nga institucionet financiare	-	-	-	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	27,629	-	-	27,629
	27,629	-	-	27,629
Ekspozimi neto	35,254	36,287	-	(1,033)
31 dhjetor 2014	Vlera kontabël	USD	EUR	Lek
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme të tjera	41,496	41,496	-	-
Paraja dhe ekuivalentet e saj	44,404	608	-	43,796
	85,900	42,104	-	43,796
<i>Detyrime financiare</i>				
Huatë nga institucionet financiare	417	-	417	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	28,997	-	160	28,837
	29,413	-	577	28,837
Ekspozimi neto	56,487	42,104	(577)	14,961

Analiza e ndjeshmërisë ndaj valutave të huaja

Analiza e ndjeshmërisë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhave të huaja në datën e raportimit dhe ndryshimet e parashikuara në fillim të vitit financiar dhe të mbajtura konstante gjatë periudhës së raportimit. Më poshtë është vlerësimi i efekteve të ndryshimit të kurseve të këmbimit në fitimin neto, duke mbajtur të gjitha variablat e tjera konstante. Tabela tregon fitimin (humbjen) në Lek kur monedhat e huaja (EURO, USD) vlerësohen ose zhvlerësohen me 10% kundrejt Lekut.

	2015		2014	
	EUR	USD	EUR	USD
Monedha zhvlerësohet me 10%	-	(3,629)	58	(4,210)
Monedha vlerësohet me 10%	(-)	3,629	(58)	4,210

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

24. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

d) Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normave të interesit është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut ka të bëjë kryesisht me detyrimet afatgjata të qerasë financiare me norma interesi të ndryshueshme. Më 31 dhjetor 2015, të gjitha huatë e Shoqërisë janë në një normë të ndryshueshme interesi (2014: 100%). Shoqëria nuk angazhohet në instrumenta mbrojtës.

e) Ndjeshmëria e normave të interesit

Tabela e mëposhtme tregon ndjeshmërinë ndaj një ndryshimi të arsyeshëm, të mundshëm në normat e interesit në atë pjesë të huave te prekura. Me të gjitha variablat e tjerë të mbajtur konstant, fitimi i Shoqërisë para tatimit është prekur nëpërmjet ndikimit në normat e ndryshueshme të huave, si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Rritje në normën e interesit 10%	-	(42)
Rënie në normën e interesit 10%	-	42

25. ANGAZHIME DHE GARANCI

Angazhime në qira operative

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 Shoqëria është palë e marrëveshjes për qira operative për marrjen me qira të zyrave. Pagesat minimale të ardhshme për këto marrëveshje janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Brenda një viti	3,402	2,574
Pas një viti, por jo më shumë se 5 vjet	3,402	1,144
Totali	6,804	3,718

Çështje gjyqësore

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë procesi gjyqësor, padie apo çështje gjyqësore të ngritur gjatë aktivitetit normal të biznesit.

26. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Pas datës së raportimit nuk ka patur ndonjë ngjarje, e cila do të kërkonte ndryshime apo paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.